



Komisioni për ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare, në bazë të nenit 28 paragrafi 8 i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritarere ("Fleta zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale" numër 046/19, 010/21, 016/21), sjell,

VENDIM

Për zgjedhjen e vlerësuesve të pavarur

1. Për vlerësuesin e pavarur për pikëzimin e projekteve të organizatave joqeveritare për vitin 2025 në komunën e Tuzit përcaktohen:
 - Maja Subotiq Medenica;
 - Radule Dragović.
2. Detyra e vlerësuesve të pavarur është të vlerësojnë projektet, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare.
3. Plotësimi i listës për vlerësimin e projekt propozimeve.
4. Dorëzimi i listës së projekt propozimeve e cila do të mbështetet nga komisioni.
5. Kompensimi për punën e vlerësuesve të pavarur do të përcaktohet me akt të veçantë.

Arsyetimi

Komisioni për ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare shpalli thirrjen publike për përzgjedhjen e vlerësuesve të pavarur për vitin 2025, numër 04-056/25-1522/1 prej më 18.03.2025. Në mbledhjen e mbajtur më 06 maj 2025, komisioni nga kandidatët e paraqitur për vlerësues të pavarur për vlerësimin e projekteve të organizatave joqeveritare për vitin 2025 zgjodhën: Maja Subotiq Medenica dhe Radule Dragović.

Neni 28 paragrafi 2 i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritarere ("Fleta zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale" numër 046/19, 010/21, 016/21), përcakton se në procesin e vlerësimit të projekt propozimeve angazhohen dy ose më shumë vlerësues të pavarur, kurse neni 28 paragrafi 5 i të njëjtit vendim, përcakton që vlerësuesit e pavarur kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre, i cili do të përcaktohet me akt të veçantë.

Vendimi për përzgjedhjen e vlerësuesve të pavarur do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Tuzit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetarja e komisionit,
Marina Ujkaj

